**SEMINARI EVROPIAN MBI URBANIZMIN TRASHËGIMOR DHE PEJSAZHIN : SHEMBULLI I BERATIT**
**(4-5 qershor 2012)**

**Fjalimi i Ambasadores së Francës,**
**Znj. Christine MORO**

Zoti Kryetar i Bashkisë së Beratit,
Zoti Zv.kryetar i Bashkisë së Bastias dhe Zv.President i Këshillit të përgjithshëm të Haute-Corse (Z. Raffalli),
Zonja Kryetare e Shoqatës (Znj. Ortiz),
Zonja dhe Zotrinj,

Jam e lumtur që marr pjesë, me rastin e vizitës time të parë zyrtare në Berat, në hapjen e këtij seminari të organizuar nga Shoqata e qyteteve të artit dhe të historisë dhe e mbështetur nga Ministria franceze e Punëve të jashtme, Ministria e Kulturës dhe Ambasada e Francës. Përshëndes pjesëmarrësit shqiptarë dhe francezë, si dhe ata bullgarë dhe rumunë: ky seminar dëshiron të jetë evropian në përbërjen e tij si dhe në ecurinë e tij, pra problematikat e qyteteve të artit dhe të historisë janë të njëjta kudo në Evropë.
Gjeneratat e kaluara na kanë lënë trashëgiminë e tyre: është një dëshmi e historisë dhe e jetësës së tyre, të cilat na kanë formuar kështu si jemi sot. Ne u detyrohemi shumë atyre sepse, siç thotë një shprehje e famshme: "një popull pa rrënjë është një popull pa të ardhme".

Le të jemi po aq bujar për gjeneratat e ardhshme sa kanë qënë paraardhësit tanë me ne. Është e vështirë sepse jeta bashkëkohore është plot me rreziqe për trashëgiminë, por ajo ka gjithashtu shumë mundësi, të cilat nuk ekzistonin më parë. Të gjithë ne duhet të gjejmë eikulibrin që do të na mundësojë të përballemi me këtë sfidë themelore: të ndërthurësh zhvillimin bashkëkohor urban me ruajtjen e zonave më të vjetra të qyteteve tona të mbushura me histori.

Pikërisht në këtë frymë Kryetari i Bashkisë së Beratit, Zoti Fadil Nasufi, duke qënë se qyteti është shpallur trashëgimi botërore nga UNESCO në vitin 2008, i bëri thirrje në vitin 2010 Shoqatës kombëtare franceze të Qyteteve dhe Vendeve të Artit dhe të Historisë për të përfituar nga përvoja e saj në fushën e trashëgimisë urbane. Disa misione janë organizuar dhe një partneritet i fortë është krijuar. Sot, ne shohim frytet e tij.

Berati është një nga qytetet më të vjetra të Shqipërisë. Gjatë pushtimit osman, qyteti përjetoi ndryshime të konsiderueshme. I vendosur në një rrugë të rëndësishme komunikimi, midis kryeqytetit dhe deti Adriatik, ai shtrihet përtej fortifikimeve. Kjo periudhë shënon një tolerancë fetare të veçantë dhe një ruajtje të trashëgimisë së krishterë ortodokse në mesin e një popullsie të madhe myslimane.

Berati mbart një dëshmi të jashtëzakonshme të bashkëjetesës së komuniteteve të ndryshme fetare dhe kulturore përgjatë shekujve, si dhe diversitetin e shoqërive urbane në Ballkan.

Klasifikimi i qendrës së vjetër të Beratit në trashëgiminë botërore të UNESCO-s në vitin 2008 i dha një shtysë të re përpjekjeve për të ruajtur qytetin dhe theksoi më tepër çështjen e legjislacionit që duhet zbatuar në këtë zonë, si dhe në zonën karakteristike, hapësira midis lagjeve të vjetra dhe të reja, në afërsi të drejtpërdrejtë dhe vizuale me zonën e klasifikuar.

Ky seminar evropian, i cili na bashkon sot, do të na mundësojë gjetjen e zgjidhjeve së bashku, të gjithë bashkë dhe sidomos me pjesëmarrjen e shërbimeve të bashkisë së Beratit, me Institutin e Monumenteve të Kulturës në Shqipëri, me Ministrinë e Kulturës.

Duhet të dini se mbështetja e Francës për qytetin e Beratit do të vijojë në shtator si pjesë e një misioni ekspertize mbi lumin Osum, në brigjet e të cilit është ngritur qyteti i Beratit. Ky projekt do të diskutojë ndër të tjera, çështjet e trajtimit të ujrave, e menaxhimit të mbeturinave dhe të zhvillimit të eko-turizmit.

Në fakt, siç do shohim gjatë këtyre dy ditëve, ruajtja e qendrave historike kalon gjithashtu nga një qasje më e gjerë, duke përfshirë këtu menaxhimin e hapësirave natyrore dhe të hapësirave të tranzicionit mes lagjeve të vjetra dhe të reja, ku është i rëndësishëm reflektimi global, i cili përfshin veçanërisht menaxhimin e njëjtë dhe të qëndrueshëm të lumenjve.

Unë e di se Berati dhe Kryetari i bashkisë kanë gjithashtu në plan për të zhvilluar një rrjet të qyteteve historike në Shqipëri. Unë jam e kënaqur që Shoqata kombëtare franceze e Qyteteve dhe Vendeve të Artit dhe Histori mbështet Beratin në realizimin e këtij rrjeti. Pasuria trashëgimore e Shqipërisë është e madhe, por e rëndësishme është të veprohet për ta ruajtur atë dhe për t'ia zbuluar botës.

I uroj shumë suksese këtij seminari dhe projekteve të Beratit, një qytet i traditës dhe i së ardhmes./.